

THE CONTRIBUTION OF WOMEN IN ELBASAN, DURING THE RESISTANCE AGAINST FOREIGN INVADERS NAZI-FASCIST KONTRIBUTI I GRAVE NË ELBASAN GJATË QËNDRESËS KUNDËR PUSHTUESVE TË HUAJ NAZI – FASHISTË

LIRA GJEVORI; SOKOL GJEVORI
Universiteti 'Aleksandër Xhuvani' , Elbasan, SHQIPËRI
gjevorilira@yahoo.it

AKTET V, 1: 677 - 681, 2012

PERMBLEDHJE

Gratë e qytetit të Elbasanit kanë luajtur një rol të rëndësishëm në luftën nacionalçlirimtare. Kontributi i tyre ka qenë jo vetëm në shpërndarjen e trakteve, në mbledhjen e ndihmave në armë, municione, por edhe në strehimin e të rinjve e të rejave duke vënë në rrezik jetët e tyre për çlirim kombëtar e shoqëror. Qëndresa e këtyre grave dhe vajzave ishte e formave nga më të ndryshme. Në qytetin e Elbasanit ishin angazhuar një numër i konsiderueshëm grash dhe vajzash si pjesmarrëse në këtë luftë. Ndër aktivistet e para ishin : Persefoni Todri, Virgjini Bishka, etj. Veprimtaria e tyre u shtri edhe në rradhët e nxënësve të Normales, të punëtove të fabrikës 'SAIDE', dhe fabrikës të duhanit. Ato qëndruan të forta me heroizëm e vetëmohim duke vazhduar luftën e tyre të drejtë në mbrojtje të atdheut dhe të drejtave të tyre për emancipim shoqëror. Shembulli i grave dhe i vajzave të qytetit të Elbasanit tregoi qartë se roli i gruas dhe i nënave shqiptare në luftën nacional-çlirimtare ishte mjaft i madh.

Fjalë kyce: Kontribut, qëndresë, luftë nacional-çlirimtare, aktiviste, veprimtari.

SUMMARY

Elbasan's women have played an important role in the national liberation struggle. Their contribution has been not only the distribution of tracts, to aid in the collection of weapons, munitions, but also to accommodate the young ones putting their lives at risk to national and social liberation. The resistance of these women and girls was the most different forms. In the city of Elbasan were engaged a considerable number of women and girls as participating in this war. Among the first activists were Persefoni Todri, Virgjini Bishka, etc. Their activity extended among the students of Pedagogical, the factory workers 'SAIDE', and the tobacco factory. They stood strong with the heroism of self-denial by continuing their fight right to protect the homeland and their rights to social emancipation. Example of women and girls of the city of Elbasan clearly showed that the role of Albanian women and mothers in the fight for national liberation was quite large.

Key words: Contribution, national liberation struggle, activists, demonstration, resistance.

1. Hyrja

Ardhja e pushtuesve Italian në 7 prill 1939 në Shqipëri nuk u mirëprit nga populli shqiptar. Në mjaft qytete, të rinj dhe të reja u organizuan në luftën e përbashkët për çlirimin e vendit. Edhe qyteti i Elbasanit u organizua në mbrojtje të pavarësisë dhe lirisë kombëtare. Do të ishin normalistët elbasanas të parët në frontin e

rezistencës dhe në fillimin e lëvizjes nacionalçlirimtare në këtë trevë. Bashkë me grupet e të rinjve u bashkuan edhe mjaft gra dhe vajza të këtij qyteti. Qëndresa e këtyre grave dhe vajzave ishte e formave nga më të ndryshme.

- Së pari në drejtim të organizimit të tyre , jo vetëm në qytet por edhe në fshat.

- Së dyti në drejtim të edukimit, pasi pothuajse pjesa më e madhe e grave dhe e vajzave ishin analfabete.

- Së treti në drejtim të mos nënshtrimit ndaj pushtuesve të huaj, dhe gjëndjes ekonomiko-shoqërore të vështirë.

- Së katërti në drejtim të rrokjes së armëve në luftë për të mbrojtur familjen dhe atdheun, duke lënë pas doket dhe zakonet patriarkale.

Gruaja shqiptare e specifikisht gruaja elbasanase ka pasur një rol të rëndësishëm në luftën nacionalçlirimtare. Kontributi i tyre ka qenë jo vetëm në shpërndarjen e trakteve, në mbledhjen e ndihmave në armë, municione, veshmbathje, ushqime, në të holla, por edhe në strehimin e të rinjve e të rejave duke vënë në rrezik jetët e tyre vetëm e vetëm për çlirim kombëtar e shoqëror. Përmendim Aspasi Naskën, Hatixhe Misirin, Mili Bahjen, Shahe Vyshka, Fatime Rosenin, Fani Robja, Shegushe Bebeti, Efrosina Dodbiba etj. Këto gra elbasanase u dalluan për ndjenjat e tyre patriotike e përparimtare.

2. Pjesëmarrja aktive e vajzave elbasanase të shkollës Normale

Mjaft nxënese të shkollës “Normale” ndërmerrnin veprime dhe aktivitete të ndryshme kundër politikës fashiste. Studentet si Liri Hakani, Aleksandra Mano, Sava Kavaja, Haxhire Myzyri, me guxim iu përkushtuan punës për zgjimin e shoqeve të tjera, kanë ndihmuar në shpërndarjen e trakteve në shkollë, në mosveshjen e uniformës së të rinjve fashistë. Rezistenca e hapur e mosveshjes së kësaj uniforme u pasua me presione, kërcënime, arrestime dhe me përjashtim nga shkolla. Në “Normalen” e Elbasanit nga nxënës e nxënese të ndryshëm lexoheshin komunikata diskutohesh, hidheshin parrulla kundër pushtuesve, bojkotohej mësimi dhe zhvilloheshin greva. Nga këshilli pedagogjik i shkollës u ndërmorën masa për ato nxënës që kishin qenë pjesëmarrës në këto greva, ku një pjesë u përjashtuan dhe një pjesë tjetër u larguan nga shkolla për një muaj. Përmendim Mynever Zaimin dhe Aleksandra Manon të cilat u dënuan me qëndrimin për një muaj larg shkollës.

Fillimisht në luftën nacionalçlirimtare në qytetin e Elbasanit u angazhuan një numër i vogël grash dhe vajzash të cilat do të kontribonin më pas në rritjen e numrit të grave si pjesëmarrëse në këtë luftë. Ndër aktivistet e para përmendim : Persefoni Todri, Virgjini Bishka, Liri Hakani, Shegushe Haxhimusai, Motrat Bylyku, Vule Zabzuni, Burbuqe Gjergji etj. Veprimtaria e tyre u zgjerua nga rradhët e nxënësve të Normales, të punëtoreve të fabrikës SAIDE, dhe të fabrikës së duhanit në të cilën punonin rreth 30 gra e vajza elbasanase, duke krijuar dhe grupet e para të grave antifashiste. Në këtë lëvizje merrnin pjesë gra dhe vajza të shtresave dhe profesioneve të ndryshme.

Ndihmesa e tyre ishte tepër e çmueshme në luftën antifashiste nacionalçlirimtare. Mjet tjetër propagandues i përdorur nga këto gra e vajza ishte edhe shpërndarja në mënyrë të fshehtë të trakteve të ndryshme kundër fashistëve dhe politikës së tyre. Përmendim aktin heroik të 14 vjeçares Flutura Misiri e cila mori përsipër të ndihmonte të vëllain e saj Sulë Misiri në shpërndarjen në qytet të trakteve lagje më lagje e derë më derë. Edhe pse u arrestua nga ushtarët fashistë me guxim e vetmohim i rezistoi rrahjeve dhe kërcënimeve. Përmendim rastin e Vule Dylgjerit e cila me një guxim të madh, dhe heroizëm e zbatoi me përpikmëri amanetin e fundit të vëllait të saj Syrja Dylgjerit për fshehjen dhe dërgimin e trakteve në vendin e duhur, duke mohuar lidhjen e saj me Syrjain në sy të fashistëve. Po atë natë traktet arritën të shpërndaheshin kudo deri në katundet më të largëta të trevës së Elbasanit.

3. Aktiviteti i vajzave dhe grave elbasanase gjatë luftës antifashiste

Pjesëmarrja në demonstrata e grave kundër pushtuesve fashist ishte një formë tjetër e qëndresës antifashiste. Në gusht të vitit 1942 autoritetet italiane në qytet intensifikuan presionin ekonomik, ndjekjet, arrestimet, burgosjet e mjaft aktivisteve të kësaj lufte. Populli i këtij qyteti i gjendur në një situatë të vështirë ekonomike në mungesë të bukës u organizua në një demonstratë të fuqishme kundër

shfrytëzimit të egër ekonomik dhe kundër masave të egra represive të marra nga pushtuesit e huaj. Pjesë e kësaj demonstrate në rradhët e para të luftëtarëve ishin edhe mjaft gra e vajza si : Mynever Zaimi, Haxhire Myzyri, Mexhite Hoxha, Aleksandra Mano etj, të cilat me parrulla në duar dhe thirrjet : “duam bukë”, “ja vdekje ja liri”, “poshtë fashizmi” iu drejtuan qëndrës së qytetit. Në këtë demonstratë u arrestuan 29 persona ndër të cilët edhe 2 gra Haxhire Myzyri dhe Mynever Zaimi. Mbas arrestimit, autoritetet fashiste ushtruan në drejtim të tyre rrahje dhe tortura të ndryshme, me synim gjetjen e organizatorëve të kësaj greve. Nga goja e tyre s’doli asnjë fjalë. Autoritetet italiane mbasi nuk ia arritën qëllimit të tyre i liruan. Theksojmë se edhe mbas lirimit nga burgu aktiviteti i tyre nuk u ndal por u forcua më tej me mjete forma të ndryshme. Aleksandra Mano pas lirimit nga njesiti gueril i qytetit dërgohet në zonën bazë të territorit të çliruar të Labinotit dhe prej andej, në cetën partizane të Çermenikës.

Haxhire Myzyri mbas lirimit të saj u aktivizua në çetën partizane ku luftoi me trimeri në rradhët e batalionit të Çermenikës. Haxhireja ishte një ndër iniciatorët dhe aktivistët e para në rradhët e gruas elbasanase që luftoi më vetëmohim në luftë kundër pushtuesve italianë por dhe në luftë për emancipimin e grave të kësaj treve. Ajo u dallua për punë të pa lodhur në çdo vend si në qytet dhe në fshat për ti sjellë lirinë vendit të saj. Së bashku me të vëllai Abdyl Myzyrin ajo u vra në dhjetor të 1943 duke u bërë një nga dëshmoret e para të këtij qyteti në luftë kundër pushtuesve fashistë. Masat e marre nga pushtuesit italianë nxitën edhe më shumë urrejtjen në popull. Mjet tjetër i qëndrësës i përdorur nga nxënësit dhe nxënëset e shkollës Normale ishin edhe aktivitete kulturore dhe artistike. Pikërisht shfaqja e dramës “Triumfi i lirisë” në dhjetor – janar të viteve 1942 -1943 përbënte një aksion të rëndësishëm në luftën kundër pushtuesve fashistë.

Në këtë shfaqje morën pjesë si aktore dhe dy vajza Liri Hakani dhe Mynever Zaimi. Efekti i shfaqjes së kësaj drame ishte i madh duke ndikuar në ngritjen e moralit të popullit elbasanas dhe në rritjen e rolit të gruas në

shoqërinë e asaj kohe. Pjesëmarrja e grave dhe e vajzave elbasanase në luftën kundër pushtuesve ndeshi në pengesa dhe vështirësi të shumta, kjo për faktin e ekzistencës së koncepteve e mentaliteteve të vjetra patriarkale dhe konservatore. Pavarësisht kushteve të vështira të shtypjes, të mohimit të të drejtave të tyre, gruaja elbasanase ashtu si të gjitha gratë e vendit tonë ka qenë faktor përparimi dhe emancipimi. Kjo luftë nuk mund të kuptohej pa pjesëmarrjen dhe mbështetjen e saj, kontributi i së cilës po rritej dita ditës e bëhej më i fuqishëm e më masiv, duke marrë pjesë në mjaft aksione të organizuara në këtë trevë. Gratë dhe vajzat elbasanase luftuan në masë dhe me ndërgjegje të plotë në këtë luftë kundër pushtuesve nazifashistë, për çlirim kombëtar dhe shoqëror të tyre, duke u bërë pjesë e organizatave antifashiste të grave në rang kombëtar.

4. Rritja e rolit dhe e pozitës së femrës në shoqërinë elbasanase

Theksojmë se vetë pjesëmarrja e gruas elbasanase në luftën nacionalçlirimtare ndryshoi pozitën e saj në shoqëri, duke lënë pas konceptet, mentalitetet e vjetra e paragjykimet fetare. Për rritjen e rolit dhe pozitës së tyre në shoqëri, këtyre vajzave dhe grave iu desh të luftonin jo vetëm kundër propagandës dhe politikës së pushtuesve nazifashistë por edhe kundër pengesave e vështirësive të nxjerra nga vet familjet e tyre dhe nga opinioni i qytetit dhe i shoqërisë në përgjithësi. Përmendim rastin e një vaje 14 vjeçare e cila kundërshtoi hapur prindërit e saj duke dalë partizane në mal pikërisht ditën e martësës së saj me një burrë disa herë më të vjetër se ajo vetëm për arsye ekonomike. Rasti i një vaje tjetër elbasanase ku i bënte thirrje nënës së saj që të bashkohesh me të ashtu sic po bënin edhe mjaft gra e vajza të tjera në demonstratat e organizuara në këtë qytet nën thirrjen se “ nënë ne të gjitha jemi njësoj për këtë ditë luftuam, duhet të demostrojmë të gjitha së bashku”. Këto vajza elbasanase ashtu sikurëse edhe mjaft vajza të tjera në mbarë vendin përbaluan me guxim e krenari thashethemet dhe opinionin patriakal të kohës.

Në një mbledhje që u zhvillua në 24 shkurt 1943, në shtëpinë e Ruzhdie Sejditin u krijuan grupimet e para të grave e vajzave antifashiste në këtë qytet. Grupet e para edukative të grave e vajzave elbasanase përbëheshin nga 7 deri 10 vetë. Nismëtaret e para të këtyre grupeve ishin: Hyqmete Konica, Fatime Misiri, Vanthi Peçini, Persefoni Todri, Virgjini Bishka, Shergushe Haxhimusaj, Liri Hakani etj. Në qytet ekzistonin fillimisht dy grupime të grave e vajzave. Grupi i parë përbëhej nga nxënëset e shkollës Normale të drejtuar nga Persefoni Todri dhe grupi i dytë përbëhej nga të rejat shtëpiake në drejtimin e Virgjini Bishkës. Mbledhjet e tjera të këtyre grave janë bërë në shtëpitë e Hysni Misirit, Ilia Trëndafilin dhe Sana Fullanit. Kjo e fundit ishte një tjetër dëshmore e luftës nazifashiste e rënë në këtë qytet.

Në maj të vitit 1943 aktiviteti dhe pjesmarrja e këtyre grave u zgjerua më shumë duke u shtrirë pothuaj në të gjitha lagjet e qytetit dhe duke formuar grupe ku diskutoheshin në to për : ngritjen e moralit të gruas, për rëndësinë e pjesmarrjes së tyre në luftë kundër pushtuesve, në mbledhjen e ndihmave të ndryshme për partizanët, në shpërndarjen e trakteve si në qytet dhe në fshat etj. Çdo lagje e qytetit kishte këshillin e gruas antifashiste. Në lagjen “Kala” këshilli drejtohej nga Sina Shuteriqi, Fani Robja, Sofie Papamihali, në lagjen Dylgjerhysen drejtohej nga Fatushe Cerma, Shergushe Abdihoxha, në lagjen Shinkoll drejtohej nga Vanthi Pecini, Polikseni Kalefi, në lagjen Sulejmanie drejtohej nga Naxhije Gjerga, Hamide Rroseni, në lagjen Hazinedare nga Hatixhe Ekmeciu, Shahu Vyshka, në lagjen Dautbej nga Hamide Tafani, Mili Bahja etj.

Në 1 maj të 1943 u ndërmor një tjetër aksion i fuqishëm dhe i organizuar i nxënësve të Normales së Elbasani. Rreth 100 nxënës të kësaj shkolle të rinj e të reja maturantë dhe të klasave të larta morën iniciativën në mënyrë vullnetare për të dalë në mal e të bëheshin pjesë e çetave partizane të trevës së Elbasanit si të çetës së Cermenikës dhe asaj të Dumresë për të luftuar kundër pushtuesve me armë në dorë dhe në mënyrë më të organizuar. Së bashku me këta

vullnetarë ishin edhe pesë vajza normaliste si: Liri Hakani, Burbuqe Gjergji, Krisanthi Gjogu, Agime Gjebrea, Meleqe Musaagai.

5. Përfundim

Iniciativa e këtyre grave si aktiviste të dalluara u shtri edhe në fshat. Ndër aktivistet e para që u dalluan në ngritjen e këshillave antifashistë në fshatrat e ndryshme të kësaj treve si në Cermenikë, Kërrabë, Bërzesh të, Qukës, Polis, Godolesh ishin: Minushe Misiri, Shefikat Stafa, Makbule Gjinia, Burbuqe Gjergji, Zibush Jaupi etj. Edhe në qytetin e Peqinit u krijuan grupimet e para të grave e vajzave antifashiste nën drejtimin e, Hatixhe Pipës, Emine Mekshit, Afërdita Kamamit, Marie Ndoit etj. Pjesmarrja e gruas në aksione të ndryshme do të pasohej me arrestime, burgosje, internime, e vuajtje të saj. Nga aksioni i 19 qershorit i vitit 1943 nga pushtuesit fashist u ndërmorën një valë arrestimesh në qytetin e Elbasanit. Nga ky operacion u arrestuan 89 persona midis të cilëve edhe 17 gra e vajza. Përmendim Mynever Zaimin, Hatixhe Trokolicin, Kleopatra Mano, Adile Mukja, Lutfije Hajdari, Afërdita Andoni etj. Këto gra e vajza elbasanase u treguan të palëkundura para torturave, kushteve të vështira të internimit, të përdorura nga pushtuesit Italian.

Me heroizëm e vetëmohim ato qëndruan të forta e të palëkundura duke vazhduar luftën e tyre të drejtë në mbrojtje të atdheut, në mbrojtje të të drejtave të tyre për emancipim shoqëror. Shembulli i grave dhe i vajzave elbasanase tregoi qartë se pesha dhe roli i gruas dhe i nënave shqiptare në luftën nacional-çlirimtare ishte dhe do të mbetej mjaft i madh.

Bibliografia

BEVAPI, K., ThËNGJILLI, P. etj. (2003), *Elbasani-Enciklopedi*, Bashkia Elbasan, Sejko, Elbasan: 491,511.

BUDA, Aleks (2005), *Kujtime*, Tiranë.

DEMIRI, Shyqyri (2006): *Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit*, Tiranë.

KITA, Petro (1971): *Elbasani në luftën për çlirim*, Tiranë: 65, 231.

KOKA, V., PUTO, A. etj. (2007), *Historia e Popullit Shqiptar- III*, Akademia e Shkencave, Toena, Tiranë: 319.

SELENICA, Teki (1928): *Shqipria në vitin 1927 (Albania in 1927)*, Tiranë: 251.

YJE të pashuar, - III, Tiranë 1972: 243, 414.

ZAIMI, Mynever (1998): *Përplasje ndër vite*, Tiranë: 90, 91.